

“SHQIPTARËT E MAQEDONISË, PRIORITETI I ÇËSHTJES SHQIPTARE” - MANUAL PËR DIPLOMACINË

Ndër vite, botimi i librit të radhës së Shaban Muratit, ka përbërë Lajm. E jo vetëm në Tiranë, por në të gjithë Shqipërinë.

Libri me titull: Shqiptarët e Maqedonisë-Prioriteti i Çështjes Shqiptare që u përrua para pak ditësh, nuk mund të përbente përjashtim sa i takon tematikës, e ca më pak shqetësimeve për problemet e ndryshme që do të duhej të preokuponin më së pari, njerëzit që merren mirëfilli me diplomaci, për llogari të shtetit shqiptar.

Edhe ky libër, ashtu si nëntë paraardhësit e tij, karakterizohet nga thellësia dhe qartësia e mendimit, si dhe shprehja thjesht e mendimit.

Prallë mund të bëhen bashkë këto cilësi të shkrimit e të shprehjes, në shumë pak njerëz. Shumica dërrmuese e njerëzve që ndjekin punën e palodhur të autorit në shtypin e përditshëm, ndër vite i kanë lexuar këto shkrime, me ndonjë përjashtim të rrallë.

Por kështu, të lidhura tematikisht dhe kronologjikisht, ato kanë vlerën e tyre të padiskutueshme dhe përbëjnë jo thjesht gjurmë, por piketa në rrugën e gjatë të mendimit diplomatik shqiptar. Piketa, kryesisht për të ardhmen, për politikën që duhet të ndërmerret shteti shqiptar në marrëdhëniet ndërkombëtare, kryesisht me fqinjët tanë vertikalë.

Ky libër, ka për leitmotiv në të 270 faqet e tij, titullin që mban: Shqiptarët e Maqedonisë-Prioriteti i Çështjes Shqiptare. Me të drejtë autori nënvizon:

- “Çështja shqiptare qëndron në rend të ditës për kombin shqiptar edhe pas pavarësimit të Kosovës, për dy arsye madhore:

1. Nuk është zgjidhur përbërësi i saj më i rëndësishëm, pas zgjidhjes së çështjes së Kosovës, që është ajo e statusit të popullit shqiptar në shtetin e Maqedonisë.

2. Nuk është mënjanuar kërcënimi strategjik ndaj përbërësve të tjerë, zyrtarisht dhe ndërkombëtarisht të zgjidhur: Shqipëria dhe Kosova, sepse çështja e këtyre dy përbërësve, mund të quhet e përfunduar kur shtetet, që përfaqësojnë këtë kërcënim strategjik, të pranojnë statusin dhe ekzistencën e këtyre dy shteteve, kur ato të ndërpresin politikatat dhe sponsorizimet shtetërore, të cilat synojnë dëmtimin e sovranitetit shtetëror dhe integritetit territorial të Shqipërisë dhe Kosovës”.⁽¹⁾

Dhe më poshtë autori thërret në mënyrën e tij unike:- “Një diplomaci serioze, që ndërton platformën e veprimit të saj mbi bazën e mbrojtjes së interesave jetike të popullit, shtetit dhe kombit të vet, nuk mund të quhet e tillë, nëse nuk merr si bazë të veprimit të saj, këto dy parametra strategjike, ende të pa zgjidhur në Ballkan të çështjes shqiptare. Çështja shqiptare duhet të identifikohet me zhvillimin e interesave mbarëshqiptare në rajon, si objektiv që shoqëron ekzistencën e kombit shqiptar, e që paraqet një vazhdimësi të vetë çështjes shqiptare. Në këtë mënyrë, ajo mbetet pjesë e pandarë e interesit kombëtar e jetik të shtetit dhe të politikës së jashtme në shekullin e ri”.⁽²⁾

Si njohës i thellë i realitetit maqedonas, edhe me cilësinë e ambasadorit të parë shqiptar në atë vend, ai jo vetëm për katër vite, por për 22 vite rresht, ka ndjekur e vëzhguar zhvillimet, me imtësi dhe me interesimin e duhur profesional, por kryesisht me nervin, që ose e ka, ose nuk e ka diplomati.

Kaleidoskopit të Shaban Muratit, nuk i shpëton asnjë lajm nga ai vend, madje do të thosha asnjë firmë që hidhet në atë shtet, sa për të drejtat e shqiptarëve atje, aq edhe për ndërtimin e një rruge apo hekurudhe që kurrë nuk u ndërtua.

Që s`u ndërtua, jo se mungonin paratë, por siç e argumenton autori, se nuk përshtatej me interesat strategjike të Beogradit.

Të gjitha këto autori i zbërthen në shkrimin me titullin më të goditur që unë të paktën me përvojën time modeste në gazetari, kam parë ndonjëherë:- “Kë pret Penelopa e Shkupit”?⁽³⁾

⁽¹⁾ Shaban Murati Shqiptarët e Maqedonisë-Prioriteti i Çështjes Shqiptare, Tiranë 2016, faqe 11

⁽²⁾ Po aty: faqe 117

⁽³⁾ Po aty, faqe 199

Dhe del për këtë temë me një deduksion të papërsëritshëm: “Mirëpo optimizmi, është një kategori që nuk jep shumë optimizëm në gjeostrategji”...

Ka patur, ka dhe do të ketë kjo jetë, njerëz që kanë ç`të shkruajnë, por nuk dinë si ta shkruajnë. E këta janë rreth dy përqind e njerëzve.

Ka patur, ka por edhe do të ketë kjo jetë, njerëz që as nuk kanë ç`të shkruajnë, e as nuk dinë si ta shkruajnë. Këta janë 97 përqind e njerëzve, që zakonisht duan të shkruajnë, pavarësisht se çfarë shkruajnë.

Ka patur, ka dhe do të ketë kjo jetë (edhe pse të paktë këta të fundit), njerëz që kanë ç`të shkruajnë, por edhe dinë si ta shkruajnë. E këta janë vetëm një përqind e njerëzimit. Nuk kemi ç`bëjmë, ne jemi të pafuqishëm ta ndryshojmë këtë realitet.

Por ne që ndodhemi sot këtu, jemi fatlumë që jemi bashkëkohës, por edhe njerëz që ndajmë preokupime e shqetësime për ato që ndodhin, për ato që nuk ndodhin, apo për ato që do duhej të ndodhnin, me Profesor Shaban Muratin.

I cili bën pjesë në këtë grupin e tretë, këtë të një përqindëshit, pra tek ata që kanë ç`të shkruajnë, por edhe dinë si ta shkruajnë.

Ajo ditë përbënte një “jubile”, pasi autori përuroi librin e dhjetë të tij. Të dhjetë këto libra, me tematikë për diplomacinë dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.

Shkruesi i këtyre radhëve, me autorin është njohur me 35 vjet vonesë, pra në fillimvitet e `2000-ta. Them fizikisht e me kaq vite vonesë, pasi me shkrimet dhe analizat e tij për marrëdhëniet ndërkombëtare, jemi rritur thujse të gjithë, të paktën ata njerëz që kanë ndjekur shtypin, e me interesa në këtë fushë.

Zemra e autorit regjetin me krenari kombëtare, kur një grup komunash që shteti maqedon i konsideronte si “maqedonas myslimanë”, ashtu siç ndodh edhe në Greqi, ku distrikte të tëra e jo thjesht qytete e krahina, janë mbiemërtuar “grekë myslimanë”, u deklaruan si shqiptarë që ishin, e që gjuhë amtare shpallën atë që kishin: Shqipen. “Ndodhi një dukuri e re-thotë autori, dukuria e kushtrimit të të parëve”...⁽⁴⁾

Jo rrallë autori fshikullon gafat dhe gabimet e politikës shqiptare në Maqedoni, e më tepër të asaj të Tiranës zyrtare për

⁽⁴⁾ Po aty, faqe 166

mungesat dhe gabimet e bëra nga mosdija, apo ca më keq në emër të interesave të dyshimta.

Ashtu siç edhe përgëzon veprime të matura apo iniciativa frytdhënëse të ndërmarra në kohë. Ai jep përcaktimin deduktiv, kur thotë: “Në qoftëse dëshiron të shkatërrosh marrëdhëniet me një shtet tjetër, mjafton të dërgosh atje, një ambasador të papërshtatshëm”.⁽⁵⁾

Për fat të keq, politika shqiptare e 25 viteve, prodhoi ambasadorë të tillë. Turpi shtetëror institucional, ishte kur u sanksionua me ligj, se x përqindje e trupit diplomatik, do të ishte emërtesë e partive të radhës!

Me përjashtime të rralla, përgjithësisht mbrojtja e interesave të Shqipërisë iu besua njerëzve delexhinj që në rastin më të mirë shkuan andej për të mbushur xhepat, e në rastin më të keq, shitën interesa kombëtare për një copë bukë.

Mbi të gjitha, i dhanë fytyrën e tyre shtetit shqiptar, në sytë e botës.

Autori për shqiptarët e Maqedonisë diku shpërthen: “Çështja e popullit shqiptar në Maqedoni ndodhet nën presione dhe diversione të mbidheshme e të nëndheshme, të strukturave dhe të qendrave antishqiptare. Ato janë kaq komplekse dhe të sofistikuara, sa që disa herë hutojnë edhe grupe intelektuale e doemos ato politike në Shqipëri, Kosovë dhe gjetkë. Këto grupe nuk njohin dhe nuk kuptojnë, ose nuk duan të kuptojnë, terrenin e vështirë, të rrëshqitshëm dhe specifik të atij shteti”.⁽⁶⁾

Për shkruesin e këtyre radhëve, do të ishte e pamundur të rrekte gjithë tematikën e Esseve dhe Analizave të shkëlqyera që ndërtojnë këtë libër.

Autori, për vetë natyrën e dytë të tij, pra gazetarinë, përbën një shkollë e vërtetë, të paktën për ne që shkruajmë në publik. Shkollë e rreptë, sa në përzgjedhjen e argumentave, aq edhe në parashtrimin me art të tyre.

Duke i përmbushur e fuqizuar argumentat, me një gjuhë të zhdërvjelltë e të pasur, duke qenë ndër shumë të paktët njerëz që kanë sukses në fjalëformim. Desha vetëm sa ta prek këtë kontribut madhor të tij, në lëvrimin e shqipes. Ndoshta shumë

⁽⁵⁾ Po aty, faqe 196

⁽⁶⁾ Po aty, faqe 268

shpejt do të realizohet ndonjë veprimtari në përmasa të tilla, vetëm me temën: “Kontributi i Prof. Shaban Muratit në lëvrimin e gjuhës shqipe”.

Është një jetë e tërë kontribut i vyer, në mijëra faqe të plota gazetash, mijëra faqe librash, në të cilat autori ka zbardhur në shqip, por edhe i ka shërbyer shqipes.